



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Në kuadër të programit të kredisë së lehtësuar për strehim me 3%, Bashkia Durrës ju njofton se çdo qytetar mund të aplikojë në portalin e-albania përmes llogarisë së tyre personale duke zgjedhur shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e Strehimit Social” duke ngarkuar dokumentat e mëposhtme:

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

- i. certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individ/familja nukka regjistrim në gjendjen civile;
- ii. vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës “a”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

- i. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) për pronat që disponohen në mënyrë të secilit anëtar të familjes;
- ii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;
- iii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) se nuk figurojnë e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- iv. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo çdo pjesëtar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese.(origjinale)
- v. aktverifikim nga njësia vendore për:
 - a. banesat në rrezik shembjeje;
 - b. rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - c. banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
- vi. vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- vii. akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018,

“Për strehimin social”:

- i) certifikatë familjare;
- ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018,

“Për strehimin social”:

- i. vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi tëkufizuara;
- ii. vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
- iii. dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
- iv. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- v. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;
- vi. urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;
- vii. vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
- viii. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- ix. vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- x. vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës “ç”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018,

“Për strehimin social”:

- i. vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t’i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- ii. dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- iii. vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- iv. vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- v. vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit do të jetë deri më **30.06.2022**